



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:162170

Datë: 03.11.2023

Numri i dokumentit: 04869687

C.nr.500/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, Rruga “L. e P.”, pn., të cilën e përfaqëson e autorizuar i saj E. G., zyrtare ligjore nga D. C. A. (D.C.A) SH.P.K. nga Prishtina, Rruga “Rr. S.”, nr.../2021, me autorizim, kundër të paditurit B. (S.) S. nr. personal, nga Podujeva, Rruga “Z. P.” nr. ..., tani me vendbanim në adresë panjohur jashtë vendit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme B. Sh.-M., avokate nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti Rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit: 665.00 Euro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 24.10.2023, në prani të palëve ndërgjyqëse të autorizuarës së paditëses dhe përfaqësueses së përkohshme të paditurit, ndërsa me datën 02.11.2023, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, Rruga “Lidhja e Pejës”, pn., **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri B. (S.) S., nga Podujeva, Rruga “Z. P.” nr. ..., që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) nga Prishtina, Rruga “L. e P.”, pn., t’ia kompensojë shumë prej 665.00 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Eurove, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarit (L. K.) në aksidentin e datës 02.11.2014 në Prishtinë, me kamatë ligjore siç e paguajnë bankat afariste të Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, po ashtu t’i paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 584.00€, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Kompanisë së Sigurimeve “D.” nga Prishtina, Rruga “Xh. D.”, pnr., sa i përket kamatës që kamata të jetë nga dita e ngritjes së padisë, në tërësi **si e pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësja, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me të cilën ka kërkuar që të detyrojë të paditurin e lartcekur, t'ia bëjë rimbursimin e dëmit në vlerë prej 665.00 Euro.

Paditësja, nëpërmes të autorizuarës së saj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovet kërkesëpadi dhe të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit, paditëses t'ia paguajë shumën prej 665.00 Euro. Ka shtuar se i padituri me datën 02.11.2014, në Prishtinë ka shkaktuar aksident trafikun, me ç'rast i ka shkaktuar dëme të dëmtuarit L. K..

I dëmtuari ka bërë kërkesë në Byronë Kosovare të Sigurimeve dhe është kompensuar për dëmin material dhe jo material, në shumën prej 665.00 euro.

Më tutje ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke shtuar se edhe në bazë të ekspertizës vërtetohet edhe njëherë shkaktari i aksidentit të trafikut të datës 02.11.2014 është i padituri, i cili në momentin e aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, andaj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë.

Shpenzimet e procedurës i kërkojmë, shpenzimet për taksë gjyqësore, për përkthim, shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, si dhe shpenzimet e ekspertizës.

Përfaqësuesja e përkohshme i të paditurit, në të përgjigjur në padi, në seancë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshtoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke shtuar se padia është e paqëndrueshme dhe si e tillë e kundërshtojmë për pagesën e shumës 665.00 euro lidhur me rimbursimin e dëmit. Gjithashtu e kundërshtojmë edhe kamatën ligjore, për arsye se kjo padi është barrë e paarsyeshme dhe e njëjta nuk ka prova të cilat vërtetojnë përgjegjësinë e të paditurit.

Andaj, nga të cekurat e dhëna, gjykatës i ka propozuar që të refuzoi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë, si dhe shpenzimet e procedurës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së, dhe atë për përgjigje në padi dhe përfaqësim në seanca.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: U lexua Dosja e dëmit numër, Transferi për të dëmtuarit dt.01.12.2014, urdhëresë për transfer bankar numër e dt.26.11.2014, Ujdi jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe të dëmtuarit L. K. numër rasti dt.24.11.2014, Vendimi me të cilin miratohet kërkesa e të dëmtuarit për kompensim dëmi numër FK-.... dt.14.11.2014, Deklarata e pronarit të riparimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit dt.02.11.2014, Faturë lëshuar nga auto servis në A-Zh. numër dt.13.11.2014, Akt vlerësimi dëmi numër dt.11.11.2014, Procesverbal mbi dëmtimin e automjetit numër dt.07.11.2014, Fotot e veturës së dëmtuar, Vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmit numër dosje 1613/14 dt.14.11.2014, Raporti Policorë numër 2014-AD-.... dt.02.11.2014, Paraqitja e dëmit dt.02.11.2014, Kopja e certifikatës së regjistrimit të automjetit me numër CRA me targa-GK, Konfirmimi i TPL :.... dt.07.11.2014, Procesverbal i kësaj gjykate me numër C.nr.500/17 dt.18.10.2022, Parashtrësë e dt.02.10.2021, Procesverbal i kësaj gjykate me numër C.nr.500/17 dt.22.12.2022, Procesverbal i kësaj gjykate me numër C.nr.500/17 dt.19.01.2022, Dëshmi - Konfirmimi mbi deponimin e mjeteve për përfaqësuesin e përkohshëm dt.02.06.2023,

Aktvendim C.nr.500/17 me të cilën është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit dt.10.07.2023, Shpallja me të njëjtin numër dhe datë, përkthyer në gjuhën Angleze dhe në gjuhën Serbe nga përkthyesja e gjykatës Sh. Z. dt.05.07.2023, njoftimi nga Gazeta Zyrtare e RKS mbi publikimin e Aktvendimit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit dt.27.06.2023, fatura .../2023 dt.24.07.2023 pagesa e shpenzimet për përkthim, nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze dhe Serbe, Dëshmi mbi pagesën e shpenzimeve për përkthim lëshuar nga B.. dt.07.08.2023, Përgjigja në padi e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit dt.08.08.2023, procesverbal i dt.06.09.2023, Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit C.nr.500/2017 dt.26.09.203 e hartuar nga Eksperti A. K..

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata, me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike dhe eliminimit të dilemave për sa i përket shkaktarit të aksidentit dhe kontributit të pjesëmarrësve në aksident, ka aprovuar propozimin e përfaqësueses së përkohshme të paditurit, dhe nxori provën me ekspertizën e komunikacionit, e hartuar nga ana e ekspertit gjyqësor Ing. A. K., ekspert i komunikacionit të dt.23.09.2023, i cili në konstatimin dhe mendimin e tij, në bazë të materialit të dhënë në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se:

- Lëshimi në këtë aksident ishte i ngasësit të automjetit A (tani të paditurit) "P. P." cili duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushte dhe rrethanat e rrugës në vendbanim nuk kishte mundur të ruaj shiritin e vetë të lëvizjes, me atë rast nga shiriti i vetë i lëvizjes kishte kaluar në shiritin e kahes së kundër (majtë), dhe si pasojë me këndin e përparmë të majtë e kishte goditur automjetin "B", në anën e majtë, përderisa automjeti "B", në atë moment ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt në shpirtin e vetë përkatës.

-Me këtë rast ngasësi i automjetit "A", kishte shkaktuar aksident trafiku me dëme material, si rrjedhojë e kësaj konstatoj se janë veprimet e ngasësit të automjetit "A", që kanë ndikuar në rrjedhën dhe shkaktimin e këtij aksidenti, dhe ato veprime i sanksionin ligji për rregullat në trafikun rrugor 05/L-088, neni 48 dhe 53.

Gjykata mendimit dhe konstatimit përfundimtar të ekspertit ia dha besimin e plotë dhe e miratoj në tërësi ekspertizën e kryer, meqë e njëjta është e mbështetur dhe argumentuar me prova, e cila ka elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive shkencore e profesionale për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore.

Nga prova raporti Policorë numër 2014-AD-... dt.02.11.2014, gjykata vërtetoi faktin se i padituri ka qenë pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit i cili ka qenë pa policë valide të sigurimit-pa mbulesë siguruese nga auto përgjegjësia, rrjedhimisht dhe pa regjistrim të automjetit.

Nga urdhëresa për transfer bankar numër 1613/14 i datës 26.11.2014, gjykata vërtetoi faktin se për Autoservis Zh. (në emër të L. K.), është kërkuar nga Departamenti i Financave që të bëhet urdhëresa për transferin e shumës prej 665.00 Euro, sipas afatit të paraparë në ujudi e cila duhet të paguhet në emër të zhdëmtimit.

Nga vendimi FK-..... dt.14.11.2014, gjykata, vërtetoi faktin se të dëmtuarit L. K., i është miratuar kërkesa për kompensimin e dëmit në automjet, e pësuar në aksidentin e trafikut me datë 02.11.2014, në shumën prej 665.00 euro.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore nr. të dt.24.11.2014, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe palës së dëmtuar L. K. është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt.02.11.2014, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 665.00 Euro.

Nga prova transferi i mjeteve në Bankën P. C. të dt.01.12.2014, gjykata vërtetoi faktin se Autoservis Zh. (për L. K.), i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 665.00 Euro, në llogarinë e tij.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi edhe provat tjera për palën e dëmtuar dhe raportet si dhe provat tjera të administruara që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar ndryshe të çështjes së ngritur me padi, nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vlerësuar provat, deklaramit të paditëses në padi dhe seancë, si dhe deklarimeve të përfaqësueses së perkohshme e të paditurit në të përgjigjur në padi gjatë seancës gjyqësore, vlerësoi se paditësja ka të drejtë në rimbursimin e dëmit nga i padituri dhe se ai nuk ka bërë përpjekjen më të vogël ta kompensoi atë, duke mos ofruar kurrfarë provash që të argumentonte të kundërtën e asaj çka pretendon pala paditëse dhe se provat e ofruara nga pala paditëse e bindën gjykatën se vërtetë ajo ka të drejtë në thëniet e saja dhe se kërkesëpadia e saj është e bazuar, duke i bërë të besueshme pretendimet.

Përkundër kësaj gjendje faktike të vërtetuar në procedurën me prova i padituri nuk e ka bërë rimbursimin e dëmit dhe për shkak të mos rimbursimit të dëmit, ka hyrë në raporte detyrimore me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse i paditurit e ka cilësinë e debitorit.

Sipas dispozitave të nenit 8 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*

Me dispozitat e nenit 245 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”*

Meqë nga gjykata në rastin konkret u vërtetua se i padituri ka mbetur në borxh ndaj paditëses, e i cili borxh u vërtetua se konsiston në shumën prej 665.00 Euro. Pasi që të dëmtuarit i është bërë pagesa e dëmit të pësuar në aksident trafiku të shkaktuar nga i padituri, i padituri nuk i ka kthyer respektivisht nuk ka bërë rimbursimin e dëmit në shumën e kërkuar. Atëherë, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartcekura në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurin që paditëses t'ia kompensojë dëmin konform dhe dispozitave të nenit 18 par.4 me të cilin përcaktohet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar.”*, lidhur me nenin 13, si dhe neneve 29 par.1 dhe 6, nenit 32 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në emër të rimbursimit të dëmit këtë shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën që e njëjta të paguhet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi i është llogaritur konform nenit 382 të LMD-së, por iu refuzua kërkesa e palës paditëse që kamata të jetë nga dita e ngritjes së padisë si e pabazuar, sepse i padituri me ditën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e ka kuptuar për dëmin e shkaktuar.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u mor konform dispozitave të nenit 449.1, 452 dhe 453.1 të LPK-së, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke obliguar të paditurin që në bazë të suksesit të paditëses në kontest e që e njëjta pati vetëm pjesërisht sukses, të njëjtës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi në shumë prej 20Euro, shumën prej 40 euro për përkthimin e aktvendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, shumën prej 150 euro për ekspertizë të komunikacionit, si dhe shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm dhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104€, si dhe për përfaqësim në dy seanca shumën prej nga 135 €, në shumë prej 270 Euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.500/2017, me datën 02.11.2023**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.